

ZHVILLIM KOMUNITETI

Përmbajtja:

Kapitulli 1

Si ka kontribuar komuniteti në procesin e organizimit për zgjidhjen e problemit

1. Komuniteti i Korçës
2. Komuniteti i Baltëz
3. Komuniteti i Moravës
4. Komuniteti i Kuçovës
5. Komuniteti i Durrësit
6. Komuniteti i Grabianit
7. Komuniteti i Levanit
8. Komuniteti i Savrës
9. Komuniteti i Novoselës

Kapitulli 2

Aktivite per Zhvillim Komuniteti

- **Korça:** Kurse profesionale për 20 vajza rrome
- **Baltëz:** Restaurim shtëpish
- **Grabian, Durrës, Novosel, Morav:** Aktivitet sportive vet-organizuese
- **Kuçova:** Kurse profesionale për të rinjtë rrom dhe Kanalizimet e ujërave të zeza
- **Savër:** Shtrim rruge
- **Levan:** Shtrim rruge
- **Grabian:** Shtrim rruge

Kapitulli 3

Aktivitetet të rritjes së të ardhurave

- **Levan:** Rritja e zogjve
- **Novosel:** Rritje patash dhe Mbarështim delesh

Kapitulli 4

- Portreti i një lideri në komunitet, Bukurie Dule
- Regjistrimi i fëmijëve në shkollë
- Rromët nxirren me dhunë nga barakat

Kapitulli 5

- 1 - Trainim i anëtarëve të Bordit Drejtues të Komunitetit
- 2 - Trajnimi i Liderave të rinj Rrom
- 3 – Vizitë për shkëmbim eksperience

Kapitulli 6: Skema e Zhvillimit Lokal dhe Lidershipit

KAPITULLI 1

Si ka kontribuar komuniteti në procesin e organizimit për zgjidhjen e problemeve.

1. Komuniteti i Korçës

Proçesi i organizimit dhe mobilizimit të komunitetit të Korçës

Vet komuniteti i Korçës ka bërë shumë hapa përpara në krijimin e një strukture të organizuar brenda komunitetit, kjo vihet re në takimet dhe diskutimet që njerëzit e këtij komuniteti kanë zhvilluar për problemet e tyre. Në këtë komunitet janë ngritur dy grupe: bordi lokal dhe grupi i nënave të fëmijëve që do frekuentojnë kopështin. Bordi lokal ka rritur ndikimin në komunitet dhe ka fituar besimin e tij. Në këtë komunitet dallohen dy lider, një është anëtar i bordit lokal dhe tjetra është grua, që përfaqëson gratë e komunitetit. Gjithashtu ka fakte dhe jo vetëm fjalë se komuniteti i Korçës ka vërtetë kapacitet për të zhvilluar komunitetin e tij dhe këtë e tregojnë më së miri shembujt e mëposhtëm, kështu: **shembulli i ndërtimit të parashkollorit, kurset profesionale, nënat e fëmijëve që do të frekuentojnë kopshtin.** Ata kanë gjetur mbështetje të komunitetit si rezultat i problemeve të përbashkëta dhe kanë bërë përpjekje për të menduar se si të zgjidhin problemet. Komuniteti është bërë më i organizuar për të luftuar për të drejtat e tij tek autoritetet lokale.

Faza e zhvillimit:

Në fillim komuniteti ishte i demoralizuar, vihej re mungesa e dëshirës për punë. Nuk kishin aftësi për organizim, apo mundësi për të ngritur kapacitet. Mungonte marrëdhënia me autoritetet lokale. Nuk ekzistonte iniciativa për të zgjidhur problemet. Por pas ndërhyrjes së Amro-Drom megjithëse e vështirë është arritur të thyhet mentaliteti në komunitet. Është kthyer besimi tek bordi lokal, njerëzit ndjehen më optimistë pasi ata kanë gjetur mbështetje apo përkrahje. Ajo që është më shumë e rëndësishme dhe që duhet parë si shumë pozitive është fakti se njerëzit në këtë komunitet kanë arritur të aktivizohen së bashku. Amaro-Drom ka treguar kontributin e tij në procesin e zhvillimit të komunitetit duke i mbështetur komunitetin në organizimin dhe mobilizimin e tij.

2. Komuniteti i Baltëz

Zhvillimi komuniteti në Baltëz

Duke krijuar lidhje mes anëtarëve të komunitetit është bërë e mundur ngritja e një qendre informacioni brënda në komunitet. Anëtarët e komunitetit marrin çdo informacion në lidhje me aktivitetet apo problemet që ata duan të ndajnë me njëri tjetrin. Shembujt e mëposhtëm do të paraqesin konkretisht zhvillimin edhe të kapaciteteve. Në komunitetin e Baltëzës ka anëtarë që janë organizuar vetë, për pastrimin e ambjentit, duke kontribuar dhe ata vetë financiarisht. Shembulli i dytë tregon për kapacitetin që ka ky komunitet në lidhje me negociimet e ndërsjellta. Vetë komuniteti duke negociuar me autoritetet lokale është përfshirë në një projekt për shtrimin e një rruge me kontributin e një inxhinieri specialist. Këto kapacitete treguan se ata janë tashmë në gjëndje për të zgjidhur vet problemet e tyre. Kjo tregon se ata kanë aftësi të menaxhojnë zgjidhjen e një problemi duke u harmonizuar bordet e strukturave sociale, ku sëbashku përbëjnë 15 anëtarë, ku 5 anëtarë janë të bordit lokal, grupi i grave (ka 10 gra) si dhe shkolla që shërben si qendër komunitare për të zhvilluar aktivitete që organizon komuniteti. Nga kjo strukturë kanë dalë dy lider. Një lidër është nga bordi lokal dhe tjetra nga komuniteti. Të dyja lideret kanë dhënë kontributin e tyre në zhvillimin e aktiviteteve kulturore në dobi të gruas rrome. Dallohen për aftësi menaxhuese, organizuese, negociuese.

Si i ka zgjidhur komuniteti problemet?

Në komunitin e Baltëzës ka patur probleme që vet komuniteti së bashku me bordin lokal ka marrë përsipër t'i zgjidh ato. Problemi i diskriminimit të fëmijëve rrom në shkollë u zgjidh duke negociuar me drejtorin e shkollës në mënyrë që fëmijët të trajtoheshin si të gjithë fëmijët e tjerë. Problemi i dytë që u ngrit nga komuniteti ishte për mungesën e një kampi veror dhe kjo u arrit nga bordi lokal në bashkëpunim me organizatën "Flidia". Kampi veror u dha mundësinë fëmijëve të argëtoheshin me lojëra zbavitëse duke i mësuar atyre gjëra të reja.

3. Komuniteti i Moravës

Zhvillimi komuniteti në Morav, Berat

Fillimisht ishte tepër vështirë për ta përfshirë komunitetin në aktivitet, mendonin se të mirat në komunitetin e tyre do t'i bënin të tjerët dhe jo ata vetë. Por hap pas hapi dhe projekt pas projekti, komuniteti së bashku me bordin arriti të ndërjegjësohej për kapacitetin që ka për të zgjidhur vetë problemet. Kjo duket qartë në këto aspekte: organizimi i grupeve të ndryshme gra, femijë dhe të rinj, në aktivitetet lokale; marrja e inisiativës për të realizuar aktivitete jashtë programit të A.D, arritja e suksesit në negociimin me Pushtetin Lokal, aktivitetet e grupeve të ndryshme u udhëhoqën me sukses nga liderat që ishin përzgjedhur në grupe, përpjekjet për të krijuar lidhje me organizata dhe institucione të ndryshme. Me kalimin e kohës anëtarët e Bordit fituan njohuritë e duhura për të negociuar në mënyrën e duhur me Autoritetet lokale, mësuan se si të ndanin detyrat dhe përgjegjësitë, si të fitonin besimin e komunitetit, si të shqyrtojnë problemet e tyre dhe të marrin vendimin për zgjidhjen e duhur. Ndërsa anëtarët e komunitetit kanë krijuar besim në aftësitë që ata kanë për t'u vetorganizuar, për të marrë vendime për përmirësimin e situatës së tyre dhe e kanë kuptuar qartë tashmë që jo vetëm puna vullnetare por edhe kontributi material janë një element i rëndësishëm për zhvillimin e komunitetit. Nga ana tjetër, anëtarët e grupeve të të rinjve dhe grave të cilët janë përfshirë në aktivitetet vetorganizuese kanë rritur besimin në vetvete për sa i përket marrjes së vendimeve së bashku, marrjes së përgjegjësiive individuale, menaxhimit të fondit

Si shembull i suksesit të negociimeve të vetë anëtarëve të bordit u duk qartë në dy projektet e fundit tek kanalizimet që komuna ka kontribuar me 20% dhe në ndërtimin e qendrës komunitare për të cilin komuna ka ofruar truallin falas dhe specialistët për bërjen e preventivit. Veç projekteve të mbështetura nga Amaro Drom, Bordi Lokal ka marrë edhe inisiativa të tjera për zgjidhjen e problemeve të komunitetit, si psh: Një problem i nxjerrë nga anëtarët e komunitetit ishte shtrimi i rrugës që të çon në varrezat e fshatit, vetë anëtarët me inisiativën e tyre kanë shtruar rrugën që të çon tek varrezat që është 150 ml e gjatë. Një problem tjetër ishte edhe përfshirja e fëmijëve të përjashtuar nga jeta social-kulturore, siç janë fëmijët jetimë. Për këtë bordi me inisiativen e vet bëri të mundur që ti ofronte këta fëmijë pranë qendrës komunitare duke i organizuar në kampe verore dhe duke u bërë në fund të këtij kampi nga një dhuratë modeste.

4. Komuniteti i Kuçovës

Mobilizimi dhe organizimi i komunitetit të Kuçovës.

Në fillim të aktivitetit anëtarët e komunitetit nuk dinin të bënin lobime tek autoritet lokale dhe nuk ishin të zotë të merrnin kontributin material (leke), por kur panë se në komunitetin e tyre ishte një problem shqetësues dhe serioz për komunitetin e tyre, atëherë anëtarët e Bordit u mblodhën me komunitetin së bashku të diskutojnë me njëri-tjetrin dhe të merrnin vendime për problemet që kishin. Mbështetur në eksperiencën e duhur, të fituara këto nga projektet e tjera, ata e diskutuan

problemin dhe negociuan në mënyrën e duhur me Pushtetin Lokal. Suksesi i negociimeve me autoritetet lokale u duk në mënyrën se si grupi u organizua për takimin në Komunë. Mënyra se si ky grup negocioi me përfaqësuesit e pushtetit lokal (parapërgatiti një strategji negociimi: shtrimi i problemit dhe pasojat e tij – dëshirën e komunitetit për ta ndryshuar gjëndjen – suksesin e aktivitetit të mëparshëm të realizuar nga vet anëtarët e komunitetit me mbështetjen e Amaro Drom, Spolut dhe Bashkisë Kuçovë).

Rritja e kapacitetit të bordit duket edhe në zgjerimin e bashkëpunimit jo vetëm për lagjen që varet nga Bashkia Kuçovë, por edhe me komunën Perondi e cila ka nën varësinë e saj lagjen tjetër periferike.

5. Komuniteti i Durrësit

Zhvillimi i komunitetit të Durrësit

Në këtë komunitet strukturat sapo kanë filluar të konsolidohen dhe të ndërveprojnë me njëra-tjetrën. Aktualisht është bordi lokal i përbërë prej shtatë anëtarësh si dhe grupi sportiv gjithashtu. Megjithëse formimi i strukturave sociale sapo ka filluar, vërehet se ato kanë një shkëmbim të mirë informacioni me njëri-tjetrin. Ka një ndarje të detyrave për anëtarët e bordit lokal ku vetë ata kanë zgjedhur dhe ndarë detyrat në bazë të aftësive dhe experiences. Një shembull negociimi me autoritetet lokale ishte zgjidhja e problemit të kanalizimeve të ujërave të zeza. Diskutimi i problemit të ndihmës sociale është akoma në negociim me autoritetet lokale për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi sepse disa familje që i përkasin këtij komuniteti u është ndaluar dhënia e asistencës pa të drejtë, për këtë anëtarët e bordit po punojnë në përpilimin e një liste që do tu paraqitet autoriteteve lokale. Njerëzit tashmë janë të ndërgjegjësuar për fuqinë që ata kanë kur bashkohen të gjithë së bashku si një zë i fuqishëm. Ka një bord lokal i cili është zgjedhur nga vetë komuniteti që përfaqëson dhe ngre zërin e tyre në kërkim të kërkimit dhe respektimit të të drejtave të tyre. Komuniteti është më i organizuar duke u përfshirë në procesin e vendimmarrjes, njerëzit janë më të lidhur me njëri tjetrin, kanë filluar të organizohen në grupe të pavarurua si ai sportiv i rinisë. Liderat kanë filluar të bëjnë të dukshëm dhe të kenë mbështetjen e njerëzve të komunitetit. Duhet akoma punë që njerëzit të mos e shohin zgjidhjen e problemeve në komunitet vetëm me anë të implementimit të projekteve.

6. Komuniteti i Grabianit

Zhvillimi i komunitetit të Grabianit

Në këtë komunitet strukturat sapo kanë filluar të konsolidohen dhe të ndërveprojnë me njëra-tjetrën, aktualisht janë bordi lokal i përbërë prej 7 anëtarësh dhe grupi sportiv prej 15 anëtarësh. Dallohen 3 lider në komunitet ku njëri është përfaqësuesi i rinisë i përzgjedhur nga vet ata. Të pakten dy prej anëtareve të bordit janë bërë negociues të mirë gjithashtu kanë arritur të ndërtojnë aleanca të tjera megjithëse kanë shumë për të mësuar. Kanë negociuar me autoritetet lokale për të kontribuar në shtrimin e rrugës me makineri, negociim ky i bërë nga anëtarët e bordit lokal, po anëtarë të bordit lokal kanë negociuar dhe arritur në marrëveshje me disa organizata të tjera lokale si: CAFOD dhe Organizata për operim dhe mobilizim e cila është një organizate fetare. Komuniteti i Grabianit ka kërkuar zgjidhjen e problemeve që e kanë shqetësuar. Fenomeni i analfabetizmit është problem shqetësues. Bordi lokal ka gjetur mbështetjen tek një tjetër (Cafod) e cila ka bërë të mundur implementimin e një projekti ku janë përfshirë grupmosha të ndryshme të cilët mësojnë të shkruajnë dhe të lexojnë. Problem tjetër ishte edhe strehimi i dy familjeve pa

strehë. Për këtë bordi lokal bashkëpunon me një organizatë fetare e cila u dha mundësi këtyre familjeve duke i financuar për të ndërtuar shtëpi.

7. Komuniteti i Levanit

Zhvillimi i komunitetit të Levanit

Në këtë komunitet ka një larmi strukturash si: Bordi lokal me 7 anëtarë, Skuadra sportive me 15 të rinj, grupi i grave me 21 persona. Vlen për t'u theksuar se të gjitha strukturat në përgjithësi i marrin vendimet në mënyrë demokratike duke përfshirë sa më shumë anëtarë të komunitetit që të jetë e mundur.

Duke u mbështetur në komunitet liderat fitojnë besimin

Liderat kanë gjetur çelësin e suksesit që është mbështetja në komunitet dhe bashkëpunimi me autoritetet lokale. Psh. në përmbytjen që ndodhi për 40 familjet e këtij komuniteti u ngrit një grup pune për të negociuar me autoritetet lokale. Në këtë grup pune kishte përfshirje të të gjitha strukturave që janë në komunitet si nga bordi lokal dhe ai sportiv. Liderat kanë filluar të kenë mbështetjen e njerëzve të komunitetit, pra kanë fituar besimin e tyre. Bordi lokal ka mirëkuptuar ekzistencën e grupeve të tjera të pavarura duke parë rezultatet e punës që janë arritur nga këto grupe. Disa herë ata janë bërë pjesë e debateve të ndryshme konstruktive duke përfshirë një numër të konsiderueshëm anëtarësh të komunitetit. Marrja pjesë në trajnime të ndryshme të organizuar nga NGO për anëtarët e komunitetit është një tjetër indikator që mbështet ndërtimin e kapacitetit duke e bashkuar dhe konsoliduar më shumë komunitetin si një zë i fuqishëm **psh** trajnim i 35 anëtarëve të komunitetit nga ana e biznesit OSBE.

Komuniteti i Levanit është përballur me disa probleme dhe ia ka dalë mbanë të menaxhojnë zgjidhjen e tyre. Vetë komuniteti arriti të zgjidhë problemin e shtrimit të rrugës që lidhte lagjen me varrezat, duke negociuar me autoritetet lokale dhe Amaro-Drom për të financuar për rrugën. Një problem tjetër që shqetësonte komunitetin ishte pjesëmarrja e fëmijëve në shkollë, si dhe ulja e numrit të analfabetëve në këtë komunitet. Për këtë u negociua me Drejtorin e shkollës nga i cili u arrit të ngrihej një grup pune që do të regjistronte fëmijët në shkollë. Një problem tjetër, i cili ishte urgjent dhe që kërkonte një zgjidhje urgjente, ishte përmbytja e 40 familjeve nga kanali i madh që ndodhet në këtë komunitet. Përmbytja erdhi si rezultat i shirave të shumtë dhe nga mospastrimi i kanalit. Bordi iu përgjigj menjëherë dhe e menaxhoi situatën duke negociuar edhe me autoritetet lokale.

8. Komuniteti i Savrës

Përpjekja e parë e përbashkët e anëtarëve të Komunitetit Rrom të Savrës për të ndryshuar gjendjen e tyre solli realizimin e suksesshëm të një miniprojekti në fushën e infrastrukturës: Shtrim rruge, Kanalizime dhe Sistem uji të pishëm.

Komuniteti rrom i Savrës u vet-organizua për të përmirësuar kushtet e tij të jetesës, anëtarët e këtij komuniteti u ndërgjegjësuat për mundësitë e përbashkëta dhe marrëdhëniet me Autoritetet Lokale janë përmirësuar dukshëm. Kjo do të thotë se besimi në mundësitë e përbashkëta është krijuar dhe anëtarët e këtij komuniteti do të vazhdojnë të kërkojnë nga vetja edhe më tepër.

Ky aktivitet i dha mundësi anëtarëve të komunitetit të diskutojnë me njëri-tjetrin, të vendosin së bashku për zgjidhjen e problemit dhe nga ana tjetër ky ishte hapi i parë drejt ndërgjegjësimit të komunitetit rrom për aftësitë dhe mundësitë që ai ka.

Bordi lokal fillimisht ka bërë takime me pushtetin lokal për vendosjen e marrdhënieve të bashkëpunimit. Akt-marreveshja për përgjegjësitë e Komunitetit, Bordit Lokal, Bashkisë dhe Amaro Drom u hartua nga qendra Amaro Drom, ndërsa anëtarët e Bordit të Komunitetit morrën përsipër negocimin me Autoritetet Lokale për marrjen përsipër të përmbushjes së detyrimeve nga ana e tyre në lidhje me projektin.

Negocimi i anëtarëve të bordit ishte i suksesshëm sepse ata me inisiativën e tyre trokitën disa herë në derën e Bashkisë Lushnje dhe arritën të fitonin besimin dhe bashkëpunimin e përfaqësuesve të këtij Institucioni.

Të gjithë anëtarët e komunitetit ishin të ndërgjegjshëm se projekti ishte në të mirë të tyre dhe përfitimi ishte në favor të shumë familjeve dhe jo të individëve të vecantë.

Banorët e lagjes nuk e shihnin atë si një shërbim apo dhuratë që iu ofrohej, por si një sfidë ku ata do të tregonin aftësitë e tyre për t'ia dal mbanë me sukses.

9. Komuniteti i Novoselës

Zhvillimi i komunitetit të Novoselës

Komuniteti ka formuar një strukturë sociale të organizuar. Ekzistojnë katër nëngrupe brënda komunitetit, bordi lokal, grupi i inisiativës ekonomike, grupi i të rinjve, grupi i grave që merren me aktivitetin e rritjes së patave. Është lideri i të rinjve, lideri që organizon gratë dhe një lider që ka dalë nga bordi lokal. Njerëzit në komunitet kanë zhvilluar aftësi për të menduar dhe formuluar opinione personale. Ata kanë filluar të mendojnë për zgjidhjen e problemeve që mund të kenë dhe rolin e rëndësishëm që ata duhet të luajnë në këtë proces. Njerëzit kanë fituar aftësi negociuese me autoritet lokale. Komuniteti është përfshirë edhe në zgjidhjen e disa problemeve si psh ai i prerjes të ujit të pijshëm. Shumë familje rome mbeten për 3 ditë pa ujë. Arsyeja ishte se uji u pre sepse disa familje nuk kishin paguar taksat në shtet. Lidhjet e tubacioneve janë në rrjet. Për zgjidhjen e problemit u angazhua bordi lokal që u ankua në komunë dhe e cilësoi si një padrejtësi për familjet që kishin qenë të rregullta në pagimin e taksave. Duke ndjekur këtë mënyrë problemi mori zgjidhje. Nga ana tjetër anëtarët e komunitetit ushtruan presion tek familjet që s'kishin paguar taksat e ujit. Megjithëse në fillim ata justifikoheshin që skishin të ardhura për të paguar; ata kanë filluar të paguajnë detyrimet kundrejt shtetit. Problem tjetër që ka zgjidhur komuniteti i Novoselës ka qenë vendosja e pompave të ujit që shërbejnë për vaditjen e tokave të tyre. Uji i çezmave nuk kishte presion të mjaftueshëm dhe të mbjellat e tyre rrezikoheshin të thaheshin. Për këtë ata kanë kërkuar ndihmë në disa organizata deri sa janë mbështetur nga organizata Eorl Vision. Ajo që është e rëndësishme për tu theksuar tek arritjet që ka Amro-Drom është thyerja e mentalitetit se komuniteti nuk ka mundësi dhe aftësi për të zgjidhur probleme. Anëtarët kanë besim tek bordi lokal.

KAPITULLI 2

Aktivite per Zhvillim Komuniteti:

1. **Korça:** Kurse profesionale për 20 vajza Rome

Përkrahimi i shkurtër i aktivitetit (çfarë është mbështetur):

Në komunitetin e Korçës janë përfshirë 20 vajza rome në kurse profesionale. 10 vajza kanë zgjedhur kurse rrobaqepësie, 10 të tjerat kanë zgjedhur kurse parukerie. Vajzat e përfshira në këto

kurse kanë qenë të gjitha shtëpiake të papërgatitura për t'u punësuar. Të rejat kanë shprehur dëshirën për të vazhduar kursin në mënyrë që të kenë mundësi të fitojnë aftësi profesionale për t'u përballur me tregun e punës. Në fund të gjitha do të pajisen me çertifikatë që njihet nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Si ndikoi / kontriboi aktiviteti për mobilizimin e komunitetit?

Ky aktivitet ka ndikuar që vajzat të bëhen aktive dhe të organizohen me njëra-tjetrën. Është hera e parë që ato kanë marrë përsipër përgjegjësi për të zhvilluar një aktivitet në mënyrë të pavarur. (**shembull**, përpara fillimit të aktivitetit vajzat kanë shkuar te bordi lokal dhe kanë shprehur dëshirën për tu futur në kurse, por kanë menduar që për çdo gjë do të mendonte bordi. Kjo gjë nuk është pranuar nga bordi, të cilët pruan t'i ndihmonin të rejat por jo të merrnin përsipër detyrat e tyre. Kështu të rejat megjithëse fillimisht nuk kanë patur besim në aftësitë e tyre kanë bërë 3 takime. Në takime ato kanë vendosur çfarë kurse do të zgjidhnin dhe kush ishte më me interes për to. Secila vajzë ka zgjedhur kursin që donte dhe njëkohësisht kanë bërë një listë me emrat e të gjithave dhe llojin e kursit. Ato kanë kërkuar vendet ku bëheshin kurset dhe kanë vendosur në cilin vend do regjistroheshin). Ky aktivitet i dha mundësinë këtyre vajzave rrome të fitojnë aftësi profesionale për t'u përballur me tregun e punës.

2. Baltëz: Restaurim shtëpish

Aktiviteti : Restaurim shtëpish

Në komunitetin e Baltëzës është realizuar projekti Restaurim Shtëpish. Janë restauruar 20 shtëpi. Familjet që përfituan nga projekti u zgjodhën në bazë të disa kriterëve (familjet më të varfëra, familjet që kishin në përbërje të tyre individ me aftësi të kufizuara, familje me të moshuar, familjet që jetonin jashtë kushteve standarte të jetesës. Vendosja e kriterëve ndikoi që të mos krijoheshin konflikte në komunitet. Familjet që përfituan nga projekti kontribuan duke bërë pagesën e specialistit si dhe një kontribut prej 5 mijë lekësh të vjetra të cilat u përdorën për organizimin e një aktiviteti kulturor për gratë (vizite në muze). Në projektin e restaurimit kontribuan dhe autoritetet lokale. Ato ofruan specialistin i cili bëri preventivet e restaurimit.

Si ndikoi / kontriboi aktiviteti për mobilizimin e komunitetit?

Realizimi i projektit Restaurim shtëpish ndihmoi 20 familje të zgjidhnin problemin e tyre për përmirësimin e banesave. Por gjithashtu motivi njerëzit për tu aktivizuar. Aktivitetet që zhvillohen në komunitetin e Baltëzës po bëjnë traditë mbledhjet komunitare. (**shembull**, Mbasi vendosen kriteret, anëtarët vendosen që do të ngrihej një komision që do të bënte verifikimin e familjeve që u zgjodhën në takim duke respektuar kriteret. Komisioni përbëhej nga 7 persona. (3 nga bordi lokal 4 nga komuniteti.)

Çfarë u mësua nga ky aktivitet?

Nga aktivitet që janë realizuar në komunitetin e Baltëzës njerëzit kanë mësuar të marrin vendime së bashku. Anëtarët në komunitet po fillojnë të kuptojnë se mund të zgjidhin vetë probleme në komunitet. Megjithatë njerëzit kanë nevojë akoma të vihen përpara përgjegjësisë për të zhvilluar më tej këto aftësi dhe të shkëputën nga mendimi se ata vetë nuk mund të zgjidhin probleme pa ndërhyrjen e faktorëve të jashtëm. Gjithashtu njerëzit po mësojnë të dallojnë detyrimet që ka pushteti lokal kundrejt komunitetit.

3. Grabian, Durrës, Novosel dhe Morav, Berat

Të rinjtë vetorganizohen në aktivitete sportive

Përshkrim i aktivitetit

Në komunitetet rrome të Durrësit, Grabianit, Moraves dhe Novoselës u mbështetën skuadrat sportive të të rinjve. Këto aktivitete i dhanë mundësinë 15 të rinjve të çdo komuniteti të pajiseshin me mjetet e nevojshme teknike për të bërë aktivitete sportive. Skuadra sportive u mbështet me pajisjet: kostume sportive, këpucë sportive, topa, dorashka, palestrina. Menaxhimi i fondit u bë nga vet të rinjtë. Të rinjtë kërkuan mbështetje tek bordi lokal për veshjet dhe do të gjenin vet fondet për mbështetjen e udhëtimeve për të bërë ndeshjet. Qëllimi i mbështetjes së këtij aktiviteti ishte të inkurajonte të rinjtë dhe ti mbështeste në aktivitete vet-organizuese, vet-drejtuese dhe vet-menaxhuese. Mbështetja e skuadrës sportive i ka inkurajuar të rinjtë dhe ka bërë të mundur që të organizohen së bashku. Skuadra stërvitet tre herë në javë, por të rinjtë takohen me njëri-tjetrin dhe gjatë ditëve të tjera të javës. Të rinjtë janë organizuar dhe kanë realizuar ndeshje me skuadra të tjera. Aktiviteti sportiv pati një efekt pozitiv për mobilizimin e të rinjve. Mbështetja që iu dha skuadrës së futbollit bëri që të rinjtë të bëheshin më aktiv dhe ndërveprues me njëri-tjetrin.

4. **Kuçova:** Kanalizimet e ujërave të zeza dhe Kurse profesionale për të rinjtë rrom nga Kuçova e Morava.

Aktiviteti i parë: Kanalizimet e ujërave të zeza

Mungesa e kanalizimeve dhe përhapja e ujërave të zeza në komunitetin e Kuçovës ishte një problem shqetësues, sidomos kur binte shi. Kjo gjendje mund të sillte epidemi apo përhapjen e sëmundjeve të ndryshme, pasi fëmijët luanin në ambjente të papërshtatshme. Në këto rrethana komuniteti e shtroi këtë problem tek bordi lokal dhe kërkoi ndryshimin e situatës. "Amaro Drom" programoi projektin që zgjati 4 muaj (shtator–dhjetor 2004). Gjatësia e kanalit është 550 ml. Ky aktivitet i dha një mundësi anëtarëve të komunitetit bashkë me bordin lokal të mblidheshin dhe të diskutonin me njëri-tjetrin dhe njëkohësisht të merrnin vendime së bashku. Në këtë mënyrë ata janë ndjerë përgjegjës për një problem të komunitetit dhe kanë parë rrugët e mundëshme për zgjidhjen e tij. Ata gjithashtu janë përfshirë gjatë punimeve të kanalizimeve dhe kanë qënë aktivë në mbarëvajtjen e punimeve. Në projektin e kanalizimeve janë përfshirë dhe autoritetet lokale që kanë dhënë kontributin e tyre me mjete teknike (makineri) dhe specialist për ndjekjen e punimeve. Por komuniteti nuk ka marrë vetëm këtë ndihmë nga autoritetet lokale, ata kanë negociuar që komuna të bëjë ndriçimin e një rrugë në lagjen Perondi ku jetojnë rromet.

Aktiviteti i dytë: Vetorganizimi i të rinjve në kurse profesionale

Përshkrimi i aktivitetit

Në komunitetin e Moravës dhe të Kuçovës është realizuar projekti i kurseve profesionale. Të rinjtë iu drejtuan bordeve të dy komuniteteve të Kuçovës dhe të Moravës me kërkesën e tyre për t'u aftësuar profesionalisht në mënyrë që të kishin mundësi punësimi për të ardhmen. Të dy bordet njëkohësisht paraqitën projekt-iden pranë Amaro-Dromit për të ndihmuar 20 të rinj nga të dy komunitetet. Projekti konsistonte në formimin profesional të këtyre të rinjve dhe qëllimi i mbështetjes së këtij aktiviteti nuk ishte vetëm aftësimi i të rinjve rrom (djem e vajza) në mënyrë që ata të kenë mundësi punësimi në të ardhmen por edhe vetorganizimi i tyre, forcimi i lidhjes së nëngrupit, forcimi i lidhjeve midis dy komuniteteve Moravë – Kuçovë, nxitja e këtyre të rinjve për tu vetorganizuar dhe për të ndihmuar të rinj të tjerë në komunitetin e tyre. Projekti zgjati 3 muaj dhe shumica e dhënë nga Spolu është përdorur për pagesën e trajnuesëve dhe shpenzimeve të trainimit.

Zhvillimi i komunitetit shihet në faktin që njerëzit nuk janë të interesuar vetëm të realizojnë projekte të tjera por më tepër të zgjidhin vetë problemet e tyre duke marrë kështu përsipër përgjegjësi dhe inisiativa për ndryshme.

5. **Savër:** Shtrim rruge

Kjo ishte eksperiencia e parë për këtë komunitet, e cila do të mbetet si përpyekja e parë e përbashkët e këtij komuniteti për të ndryshuar situatën e tyre.

Aktiviteti: Shtrim rruge, kanalizime dhe system ujsjellësi.

Qëllimi i projektit: Zhvillimi i Komunitetit Rrom Savër, Lushnje

Objektivat:

- Vet-organizimi i komunitetit rrom;
- Përmirësimi i kushteve të jetesës së komunitetit;
- Ndërgjegjësim i komunitetit rrom për aftësitë dhe mundësitë e veta;
- Përmirësim të marrdhënieve të komunitetit rrom me Autoritetet Lokale.

Realizimi i projektit ishte një nevojë për këtë komunitet. 65 ml rrugë u shtrua me cakull dhe stabilizant. 65 ml kanalizim u ndërtua me tubo dhe blloqe betoni. Sistemi i ujsjellësit u realizua po në të njëjtën rrugë dhe një cesmë e përbashkët u ndërtua në qendër të tij.

Idea për shtrimin e rrugës, kanalizimin dhe ndërtimin e ujsjellësit erdhi nga vet komuniteti duke qenë një shqetësim për qarkullimin, një domosdoshmëri për shëndetin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve të lagjes.

Për realizimin e projektit është përfshirë një pjesë e mirë e banorëve të këtij komuniteti. Nën drejtimin e bordit lokal ata janë organizuar me punë vullnetare dhe realizimin e detyrave të ndryshme gjatë implementimit të projektit.

Në projekt janë përfshirë dhe Autoritetet Lokale që kanë dhënë kontributin e tyre sipas aktmarreveshjes së nënshkruar midis Bordit Lokal - Bashkisë Lushnje - Amaro Drom:

- Përgatitjen e preventivave nga tekniku i Bashkisë;
- Përcaktimin e linjes ku u shtri kanali dhe tubat e ujit.

Roli i bordit lokal ka qenë tepër i rëndësishëm për realizimin e projektit. Bordi e filloi punën e tij me takime me komunitetin për të nxjerrë problemet dhe nevojat më emergjente të komunitetit. Nga këto takime është marrë idea për realizimin e projektit (shtrimi i rruges, kanalizimi dhe ndërtimi i sistemit të ujit të pishëm) që do të përmbushte një nevojë të komunitetit. Pas këtij hapi anëtarët e bordit morrën takime të ndryshme me Bashkinë Lushnje për hartimin e preventivit të punimeve nga një specialist i këtij Institucioni.

Për realizimin e projektit kërkohej përfshirja me punë vullnetare e anëtarëve të komunitetit dhe për këtë Bordi ka bërë një punë të madhe për ndërgjegjësimin e komunitetit për interesin e përbashkët të projektit si dhe për rëndësinë e realizimit të projektit nga vet komuniteti rrom. Gjatë fazës së zbatimit të projektit komuniteti dhe vet Bordi janë përfshirë në punën me krahë në menyrë vullnetare. Për realizimin e projektit dhe organizimin e komunitetit bordi hartoi një plan pune në të cilin përcaktoheshin qartë hapat që do të ndiqeshin, koha dhe rëndësia e realizimit të suksesshëm të projektit. Gjatë realizimit të projektit antarët e komunitetit janë përfshirë jo vetëm duke dhënë kontribut vullnetar (punën me krah) por edhe duke dhënë kontribut financiar për pagesën e mjetit mekanik për hapjen e një pjese të fortë të kanalit. Anëtarët e komuniteti janë të kënaqur për

realizimin e projektit dhe kanë shprehur gatishmerinë e tyre për t'u angazhuar në aktivitete të tjera të përbashkëta

Pas përfundimit të suksesshëm të projektit Bordi organizoi dhe një ceremoni për inaugurimin e punimeve në të cilën morrën pjesë anëtarët e komunitetit, Autoritetet Lokale, Amaro Drom, Organizata të tjera që operojnë në rrethin e Lushnjes, anëtarë të maxhorancës dhe Televizionet lokale.

6. Levan: Shtrimi rruge.

Në komunitetin rrom të Levanit u realizua projekti i infrastrukturës për shtrimin e rrugës. Rruga e shtruar në këtë komunitet kishte gjatësinë 1000 ml dhe kalon në mes të lagjes së komunitetit dhe të nxjerrë tek varrezat, kjo e fundit tregon qartë arsyen e mbështetjes së këtij komuniteti për realizimin e projektit. Tashmë duket qartë se çfarë është përmirësuar, përmirësim të cilin mund ta vësh re sidomos gjatë stinës së dimrit, ku më përpara kjo rrugë e mbuluar nga balta vështirësonte kalimin e njerëzve dhe sidomos të makinave. Ky projekt pati një impakt pozitiv tek anëtarët e komunitetit. Si fillim anëtarët e komunitetit ishin shumë të vendosur për të përfshirë si prioritet të 6-mujorit këtë projekt, për këtë ata patën një ndikim shumë të madh tek bordi lokal për të ushtruar presion tek autoritetet lokale dhe tek Amaro-Drom (e cila kishte vendosur të mos mbështeste me infrastrukturë në këtë komunitet). Kështu u realizuan një sërë takimesh me autoritetet lokale për të negociuar se si do të kontribuonin ata në këtë projekt, për negociimin u përdorën mbledhje të hapura ku përveç anëtarëve të bordit pati edhe njerëz nga komuniteti për të cilën mendoj se ka luajtur një rol vendimtar në negociimin e suksesshëm që ata arritën (mbështetje me 40% të shumës totale të buxhetit).

Çfarë është mësuar?

Njerëzit janë bërë të ndërgjegjshëm se jo të gjitha gjërat janë të mundshme për ta, por me përpjekje, ata mund të arrijnë atë çfarë duan. Ata kanë filluar të kuptojnë që jo çdo problem kërkon një projekt apo një donator. Në shumë raste, zgjidhja është Brenda komunitetit, ata duhet vetëm të gjejnë mënyrën e duhur. Gratë kanë mësuar të vet-organizohen dhe të kërkojnë zgjidhje të fuqishme për problemet e tyre.

7. Grabian: Shtrimi i rrugës

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit

Dihet tashmë që në të gjitha komunitetet rrome ka një mungesë të theksuar të infrastrukturës e cila jo në pak raste është kthyer në një nga problemet më jetike për anëtarët e komunitetit dhe si rezultat i kësaj në shumë raste ne jemi pika e tyre e vetme e referimit megjithë insistimin tone për t'i drejtuar ata tek autoritetet lokale. Në këtë projekt janë shtruar 300 ml rrugë në cilën është mbështetur çakull dhe stabilizant. Si dhe komuna që ka ofruar makineritë. Rruga është ndarë në dy pjesë për të dyja lagjet rrome, secila nga 150ml. Pati vështirësi në implementimin e këtij projekti, për shkak të motit të keq.

Aktiviteti mobilizon komunitetin

Duke qënë se është diçka e dukshme (aktivitet në infrastrukture), njerëzit janë më të tërhequr në përfshirjen e tyre dhe kontributin për këto projekte, sigurisht duke patur në mendje punën me krah pra kontributin vullnetar të cilën e kanë ofruar. Puna është e organizur në dy faza. Në fazën e parë u shtrua në qëndër dhe pastaj në lagjen e re, ajo çka vlen për tu theksuar është se anëtarët e komunitetit kanë ndihmuar njeri tjetrin pra, anëtarët e komunitetit që banojnë në qëndër të fshatit

janë ndihmuar nga anëtarët e komunitetit që banojnë në lagjen e re dhe anasjelltas, ku një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe bordi lokal.

KAPITULLI 3:

Aktivitetet të rritjes së të ardhurave në komunitete

Aktivitete të ndryshme për rritjen e të ardhurave janë mbështetur ne Levan (rritje derri), Morav (mbarshtrim rosash) dhe Novosel (rritje delesh).

1 - Levan: Aktivitetet vetorganizuese “Rritja e zogjve”

Në këtë aktivitet në të cilin janë përfshirë një grup grash, gjithsej 21 persona, janë blerë zogj të vegjël për t’u rritur. Çdo anëtar ka marrë shumën prej 21 Euro për të blerë zogj, shumë e cila është marrë hua. Në fillim ideja e këtij projekti ishte përfshirja e 15 grave, pasi ato u mbledhen dhe diskutuan me njëra-tjetrën, vendosën të përfshinin edhe 6 gra të tjera për të minimizuar huanë që do të merrnin. Nga takimet e realizuara në qendrën komunitare ato zgjodhën edhe 3 gra të cilat do të drejtonin këtë aktivitet. Njëra nga gratë ka për detyrë mbajtjen e llogarisë dhe dy të tjerat me organizimin e grave në diskutime të ndryshme që ato do të duhet të marrin pjesë për ta organizuar më mirë veten e tyre dhe për të menduar një mënyrë për shtrirjen e aktivitetit të tyre. Gratë kanë filluar të jenë më kompakte me njëra-tjetrën, me të lidhura këtë e mbështes në vendimin që ato kishin marrë për kthimin e huas. Disa nga gratë humbën një pjesë të madhe të zogjve si pasojë e përmytjes. Me normalizimin e situatës gratë u mbledhen dhe vendosen ta shtyjnë afatin e kthimit të huasë që kishin vendosur në fillim, për të ndihmuar gratë të cilat u prekën nga kjo përmytje.

2 - Novosel: Rritje patash dhe Mbarështim delesh

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:

Aktiviteti Mbarështim Patash është një aktivitet vet-organizues që u ka dhënë mundësinë 11 grave në komunitetin e Nevoelës të organizohen së bashku.

Si ndikoi / kontriboi aktiviteti për mobilizimin e komunitetit?

Gratë që janë përfshirë me rritjen e patave janë të gjitha të papunësuar, shtëpiake. Inisiataiva për t’u marrë me rritjen e patave u dha një mundësi për tu aktivizuar. Ato kanë formuar një grup që takohet 2 herë në muaj në qendrën komunitare. Gjatë takimeve ato diskutojnë jo vetëm për aktivitetin por edhe për problemet që hasin në jetën e përditëshme. (**shembull**, përveç takimeve që organizojnë 2 herë në muaj ato janë mbledhur edhe 2 herë të tjera dhe kanë pirë kafe së bashku dhe kanë kaluar kohë duke folur për problemet e tyre). Gratë në mënyrë të pavarur kanë marrë përgjegjësi, kanë formuar rregullat e grupit dhe janë aktive për t’i përmbushur ato. Ky aktivitet ka ndikuar që këto gra të organizohen së bashku. (**shembull**: Një nga gratë pjesëmarrëse në aktivitet theri njërën nga patat. Kjo situatë krijoi konflikt në grup, sepse u thyen rregullat që ishin të vlefshme për gjithë grupin. Gratë e tjera u organizuan një takim dhe diskutuan si do të vepronin. Të gjitha së bashku shkuan në shtëpinë e gruas që theri patën. Ato vendosen ta nxitnin atë të zëvendësonte patën e therur ose të kthente lekët dhe të dilte nga grupi. Ky veprim i grupit ndikoi për të zgjidhur konfliktin dhe detyroi gruan që theri patën të blinte një tjetër).

Takimet që gratë organizojnë kanë filluar të nxisin tek ato dëshirën jo vetëm për të shtuar aktivitetin e rritjes së patave por edhe për të realizuar aktivitete të tjera (**shembull**: për 8-marsin festën e gruas

kanë dëshirë të organizojnë një festë ku gjysmat e shpenzimeve do ti mbulojnë vetë, për pjesën tjetër do të kërkojnë mbështetje. Është hera e parë që gratë duan të organizohen për të celebruar këtë festë së bashku). Ky aktivitet ka ndikuar që gratë të bashkëpunojnë, të mbështesin njëra-tjetrën dhe të arrijnë të organizohen së bashku.

Mbarështim delesh

15 familje janë përfshirë në projektin e inisiativës ekonomike “ Mbarështim delesh”.Çdo familje ka marrë nga 3 dele. Nga këto 3 dele njëra ka qenë mbarse një dele ka qenë me një qengj. Ideja për tu përfshirë në këtë project ka qenë e vetë anëtarëve të komunitetit, për të rritur të ardhurat familjare. Familjarëve u është dhënë shuma e lekëve në formë huaje të cilat do të kthehen pas një viti e gjysëm. Përcaktimin e periudhës për kthimin e huas e vendosën vetë familjet e përfshira në projekt. Për kthimin e lekëve çdo familje ka nënshkruar një akt-marrveshje. Në projekt janë përfshirë familjet që kanë nivel ekonomik të ulët, kanë experiencë në rritjen e deleve, infrastrukturë për zhvillimin e projektit

Me anë të këtij aktiviteti njerëzit janë motivuar të luajnë një rol aktiv për përmirësimin e të ardhurave familjare. Por njëkohësisht ata kanë zhvilluar dhe aftësi. Gradualisht njerëzit kanë mësuar më shumë informacion dhe njohuri për shtimin e aktivitetit të tyre. Anëtarët e përfshirë në këtë projekt kanë organizuar disa herë takime së bashku, ku kanë diskutuar sesi mund ta shtojnë aktivitetin e tyre në bazë të mundësive dhe potencialeve që kanë në dispozicion. Ky ka qenë një stimul për të shkuar një hap më përpara në zhvillimin e tyre. Ata kanë filluar të mendojnë jo vetëm për momentin por janë orientuar drejt së ardhmes.

KAPITULLI 4

Përgatiti: **Diella Vuka, Gazetare**

Personazh

Portreti i një lideri në komunitet, Bukurie Dule një shembull që duhet ndjekur

Bukurie Dule me iniciativën e saj arriti të fuste në bankat e shkollës 35 fëmijë romë që ishin analfabetë. Bukuria është një grua 55-vjeçare dhe është anëtarja më e re e bordit të Levanit. Tashmë fëmijët i ka të rritur dhe nuk ka shumë angazhime në familjen e saj. Bukuria, përveç punëve të saj të përditshme në shtëpi, si nënë dhe si gjyshe, ka gjetur një mënyrë shumë frytdhënëse për t'u angazhuar në kohën e lirë. Ka rreth një vit që është bërë anëtare e Bordit të Levanit. Ajo aktivizohet me shumë probleme të komunitetit: si me fëmijët, me gratë apo edhe me të rinjtë. Që në fillim, ajo ka arritur të kuptojë shumë mirë se cilat janë problemet që shqetësojnë më shumë komunitetin e saj dhe është përpjekur të gjejë mënyrat për të kontribuar në ndryshimin e gjendjes së tyre. Këtu ka zënë fill edhe iniciativa e saj për të kontribuar në edukimin e fëmijëve. Së bashku me sekretaren e Bordit të Levanit ajo e ka marrë vet kurajon që të dalë shtëpi më shtëpi për të takuar prindërit dhe vetë fëmijët që nuk kanë shkuar në shkollë. Ajo ka biseduar me prindërit e fëmijëve dhe i ka bindur se është shumë e rëndësishme që fëmijët e tyre të shkojnë në shkollë. “Nëse ata nuk shkojnë në shkollë dhe të arsimohen, për ta e ardhmja do të jetë shumë më tepër e vështirë nga ç’është sot, - thotë Bukurie Dule. Prandaj, me iniciativën time dhe me një dëshirë të madhe arrita të fus në bankat e shkollës rreth 35 fëmijë romë”. Kështu arsyeton Bukuria dhe është e bindur se ka bërë një punë të madhe në këtë drejtim. Puna bindëse me prindërit dhe ndihma simbolike në veshje dhe pajisje shkollore për fëmijët, ka bërë të mundur futjen në shkollën e Levanit të rreth 35 fëmijëve. Disa prej tyre kanë qenë në klasën e parë dhe janë ulur për herë të parë në bankat e shkollës, ndërsa të tjerët

ishin fëmijë që e kishin lënë shkollën në mes. Një pjesë e tyre ishin analfabetë dhe me këmbënguljen dhe nxitjen e Bukuries ata janë inkurajuar të shkojnë përsëri në shkollë për të arritur nivelin e bashkëmoshatarëve, pavarësisht nga prapambetja e theksuar e tyre.

Por ajo nuk merret vetëm me fëmijët. Bukuria është angazhuar edhe me trajnimet që janë bërë në këtë komunitet për gratë. Disa herë gratë e komunitetit të Levanit janë mbledhur dhe kanë bërë trajnime në lidhje me problemet familjare, shoqërore dhe shëndetësore që ato përballen. Komuniteti është shumë i kënaqur me punën e Bukuries. Edhe vetë prindërit mendojnë se fëmijët është më mirë ta kalojnë kohën në bankat e shkollës sesa në rrugë. Edhe bordi lokal dhe Qendra “Amaro Drom” është e kënaqur me punën e saj. Ajo po luan një rol aktiv në Bordin e Levanit.

Regjistrimi i fëmijëve në shkollë

Përpjekjet e “Amaro Drom” për regjistrimin e fëmijëve për vitin shkollor 2004-2005

Për periudhën shtator-tetor regjistrimi i fëmijëve në shkollë ka qenë prioriteti numër një i Unionit të Romëve të Shqipërisë “Amaro Drom”. Në strategjinë e qeverisë shqiptare për komunitetin rrom një vend të rëndësishëm zë edhe arsimit. Për regjistrimin e fëmijëve në shkollë për vitin 2004-2005 është bashkëpunuar me drejtoritë arsimore nëpër rrethe dhe shoqata të tjera joqeveritare. Unioni i Romëve “Amaro Drom” e shikon si përparësi të punohet me brezin e ri, në mënyrë që të përfshihen denjësisht në sfidat shoqërore në të ardhmen. “Amaro Drom” bëri të pamundurën që me anë të bordeve lokale nëpër rrethe të regjistrojë sa më shumë fëmijë rromë në shkollë. Për këtë anëtarët e bordit morën kontakte me familjet e tyre dhe u përpoqën të gjejnë mënyrat për t’i dërguar ata në shkollë.

Si paraqitet regjistrimi i fëmijëve në shkollë në komunitete

Në Baltëz, në klasën e parë janë regjistruar 20 fëmijë, në klasën e dytë 16 fëmijë, në klasën e tretë 6 fëmijë, në të katërtën 16 fëmijë, në të pestën 5 fëmijë, në të gjashtë 3 fëmijë, në të shtatën 4 fëmijë dhe në të tetën nuk ka asnjë fëmijë rrom të regjistruar për të ndjekur shkollën. Gjithashtu, për shkollën e mesme nuk ka pothuajse asnjë rrom. Sipas të dhënave që ka shoqata nga bashkëpunimi me bordin lokal të Fierit rreth 30 fëmijë rromë nga mosha 10-16 vjeç e kanë braktisur shkollën. Për këtë bordi lokal i Baltëzës po bën maksimumin për të biseduar me fëmijët që ata të mund ta vazhdojnë shkollën. Sipas të dhënave të bordit, ata janë shkëputur nga shkolla për arsye se familjet e tyre nuk e mbështesin dot koston financiare të shkollimit të fëmijëve të tyre. Ata nuk kanë lekë të blejnë librat, çantat e shkollës dhe pajisjet e tjera të nevojshme. “Mendojmë të gjejmë një mësues që të punojë me një klasë mikse me nxënës të moshave të ndryshme për të zhvilluar disa orë mësimi 1-2 herë në javë, në mënyrë që këta fëmijë rromë të mund të mësojnë shkrim dhe lexim”, thotë Latif Kazanxhiu, kryetar i bordit lokal të Baltëzës

Novosela. Në klasën e parë kanë shkuar tetë fëmijë. Analfabetë, duke përfshirë edhe moshat e rritura, janë dhjetë. Ndërsa ata që frekuentojnë shkollën janë gjashtë fëmijë. Për fëmijët që shkojnë në shkollë është ofruar veshmbathje, kancelari, duke përfshirë lapsa, fletore dhe lodra për fëmijë. Për të bërë të mundur pjesëmarrjen e fëmijëve në shkolla është e domosdoshme që familjet e tyre të ndihmohen materialisht. Familjet rrome jetojnë në kushtet e një varfërie të skajshme.

Grabiani, Janë 25 fëmijë të regjistruar në klasën e parë, nga të cilët vetëm gjysma prej tyre kanë shkuar në shkollë dhe pjesa tjetër jo. Në Grabian për klasën e parë duhet të bëhen orë suplementare për të mësuar gjuhën shqipe. Përveç katër orëve të detyrueshme. CAFOD-i po ndihmon në realizimin e orëve suplementare. Sipas Ajet Fetahut, nëse nuk organizohen orët suplementare, sidomos për mësimin e shqipes, fëmijët rromë mbesin prapa nga nxënësit e tjerë. Ata edhe në klasën

e parë nuk e kanë nivelin e njohurive të fëmijëve të tjerë jorrom. Një kishë kristiane u ka siguruar veshje.

Levan. Fëmijët që futen në klasën e parë, gjendja civile nuk i pajiste me çertifikata për arsye se familjet nuk kanë shlyer detyrimin mbi taksën e tokës. Bordi lokal ka takuar kryetarin e komunës duke i dhënë shkresë zyrtare zyrës së gjendjes civile për të bërë të mundur regjistrimin e fëmijëve. Është bërë e mundur transportimi i fëmijëve në mëngjes dhe kthimi i tyre. Bordi lokal mori takime edhe me pjesëtarë nga zyra e prefekturës dhe të drejtorisë arsimore.

Një problem tjetër që shqetësonte komunitetin ishte pjesëmarrja e fëmijëve në shkollë si dhe ulja e numrit të analfabetëve në këtë komunitet. Për këtë u negociua me Drejtorin e shkollës nga i cili u arrit të ngrihej një grup pune që do të rregjistronte fëmijët në shkollë. Gjithashtu u ngrit edhe komiteti i prindërve ku kryetar është zgjedhur Refit Dule, i cili është edhe kryetar i bordit lokal, për çdo fëmijë që mungon në shkollë, drejtori i shkollës informon Refitin, i cili e ndjek këtë problem më nga afër:

Moravë - Berat, janë regjistruar për frekuentimin e shkollës 52 fëmijë nga klasa e parë deri në të katërtën. Ky është një numër i ulët në krahasim me vitet e tjera sepse shumë familje kanë ikur në Greqi. UNICEF-i gjatë verës ka organizuar kampe verore, ku ndër të tjera janë bërë edhe rifreskim i njohurive të shkollës.

Korça. Pesë fëmijë të moshës së rritur në 10-11 vjeç janë analfabetë. Gjatë verës fëmijët janë përfshirë në shkollat verore me qëllim që të pranohen në klasën e parë. Dhjetë fëmijë, mosha 7 vjeç, janë regjistruar në klasën e parë në shkollën “Naim Frashëri” dhe “Ismail Qemali”. E frekuentojnë shkollën nga klasa e parë deri në të tetën rreth 70 fëmijë. Shumë fëmijë mbeten të paregjistruar për arsye se zyrat e gjendjes civile nuk u japin çertifikatat, për faktin se familjet nuk i kanë paguar taksat.

Saver: në Saver është dhënë një shembull i mirë i përpjekjeve për regjistrimin e fëmijëve në shkollë. Bordi lokal i “Amaro Drom”, në bashkëpunim me CAFOD-in kanë hapur kurse kundër analfabetizimit, ku janë regjistruar rreth 12 persona analfabetë nga mosha 14-40 vjeç. Pavarësisht nga mosha të ndryshme ata kanë arritur t’i grupojnë në klasa mësimore për të mësuar të lexojnë dhe të shkruajnë.

Rromët nxirren me dhunë nga barakat

Komuniteti Rrom i Lanës

Rreth 25 familje hidhen në rrugë në të ftohtin e janarit.

Rromët bëhen objekt i një racizmi flagrant në kryeqytetin e Shqipërisë në Tiranë. Në mesnatën e 6 janarit policia ndërtimore shkon në barakat e tyre dhe i nxjerr me forcë përjashta duke ushtruar dhunë. Ky veprim është bërë në prezencë të Policisë Ndërtimore, Policisë së Rendit, pronares së truallit Znj Miranda Boci dhe të skuadrës “Shqiponja”. Autoritetet e policisë ndërtimore deklarojnë se kanë zbatuar vetëm ligjin. Në errësirën dhe në të ftohtin e natës, familjarët kanë rezistuar për të mos e lënë strehën e tyre, por ka qenë e kotë. Fadromat i kanë vënë para barakat duke i shkatërruar. Nën at rrome me fëmijët e tyre në krah janë nxjerrë në të ftohtin e dimrit. Panorama është e dhimbshme; fëmijë duke qarë, nënat duke mallkuar, dhe burrat veçse kanë kërcënuar dhëmbët në përballjen me policinë. Gjatë kësaj nate një i ri rrom 26-vjeçar, Dritan Hashimi, ka vdekur. Ai u dërgua në Spitalin Ushtarak nga banorët me shpresën se do bëhet diçka por kur ka mbërritur atje ai kishte dhënë frymën e fundit. Familjarët e kanë mbajtur trupin e tij mbi gërmadhat e shtëpive të tyre

për t'i bërë nderimet e fundit. Mëngjesi i 7 janarit i ka gjetur këto familje pa strehë, në mes të rrugës, të fyer, të nëpërkëmbur dhe një i ri i vdekur, që e kanë përcjellë në varreza.

Unioni “apelon”

Unioni i Rromëve të Shqipërisë “Amaro Drom” e denoncon ngjarjen e Lanës si një diskriminim flagrant i të drejtave themelore të njeriut, që i ndodh minoritetit rrom në Shqipëri. Këta banorë nuk kanë të ardhura të fillojnë ndërtimin e shtëpive me forcat e tyre. Përpjekjet për largimin e banorëve kanë filluar që në vitin 2002. Unioni “Amaro Drom” ka kërkuar nga Bashkia e Tiranës zgjidhjen më të mirë të mundshme për këto familje që nuk kanë ku të fusin kokën, përveç barakave të veta që kishin në bregun e Lanës.

Unioni “Amaro Drom” proteston për lënien në harresë të Minoritetit Rrom në Shqipëri. E gjithë kjo situatë ka precipituar si rezultat i mungesës së vëmendjes që tregon qeveria shqiptare për kushtet jetësore në të cilat jeton minoriteti rrom në Shqipëri.

KAPITULLI 5

1 - Trainim i anëtarëve të Bordit Drejtues të Komunitetit Rrom të Savrës, Lushnje

«Ne anëtarët e Bordit Drejtues të Komunitetit Rrom Savër jemi të bindur se puna jonë është sa e lehtë po aq dhe e vështirë. Ne do të angazhohemi me përkushtueshmëri dhe vendosmëri për zhvillimin e komunitetit rrom të Savrës nën moton “Të gjithë në punë për një qëllim të përbashkët”»

Qëllimi i trainimit: Ngritja e kapacitetit drejtues të Bordit Drejtues të komunitetit Rrom Savër për zbatimin e metodës “Zhvillim Komuniteti”.

Çështjet e trajtuara:

- Puna në Skuadër;
- Përcaktimi i Objektivave;
- Strategjia e pjesmarrjes;
- Vullnetarizmi

Trainimi u realizua para fillimit të punës për realizimin e projekteve në mënyrë që Bordi Lokal të krijonte një vizion të qartë të mënyrës se si duhej zbatuar projekti, si dhe përse ishte e rëndësishme të aktivizohej komuniteti dhe përse ishte e rëndësishme përfshirja dhe krijimi i marrëdhënieve pozitive me Autoritetet Lokale.

Gjatë diskutimit pjesmarrësit vlerësuan transparencën në vendim marrje dhe deklarimin e fondeve si një element shumë të rëndësishëm për krijimin e besimit në komunitet dhe për përfshirjen e komunitetit në aktivitetet e ndryshme. Pjesmarrësit ishin të qartë dhe të bindur për rëndësinë e vet-iniciativës, vet-organizimit, vendim marrjes, transparencës, komunikimit, vullnetarizmit, korrekteses dhe ndershmerise, gjithpërfshirjes, qendrueshmerise, vet-vleresimit, qëllimeve të përbashkëta dhe krijimit të besueshmërisë në komunitet.

Trajnimi ishte një element i domosdoshëm në krijimin e një Bordi kompakt, të lidhur dhe në krijimin e një vizioni të qartë dhe të përbashkët të anëtarëve për punën që ata do të vazhdonin në të ardhmen. Tregues i kësaj është marreveshja që ata bënë me njëri tjetrin:

«Ne anëtarët e Bordit Drejtues të Komunitetit Rrom Savër jemi të bindur se puna jonë është sa e lehtë po aq dhe e vështirë. Ne do të angazhohemi me përkushtueshmëri dhe vendosmëri për zhvillimin e komunitetit rrom të Savrës nën moton “Të gjithë në punë për një qëllim të përbashkët”»

Trainimi i Bordeve Levan, Moravë dhe Novosel:

Temat e zhvilluara:

- Si të hartojmë dhe përgatisim një projekt propozim
- Ngritje fondesh
- Lidershipi

Qëllimi i trajnimit ishte të rriste nivelin profesional të organizatave lokale dhe të përmirësonte punën e tyre në komunitete programi i trajnimit ndikoi ndjeshëm për mënyrën sesi organizatat lokale punojnë në komunitet. Njohuritë e përfituara gjatë trajnimit mbi hartimin e një projekt propozimi do të ndikojë që organizatat lokale të dinë të shfrytëzojnë burime të ndryshme për zgjidhjen e problemeve në komunitet. Në këtë mënyrë organizatat krijojnë partneritete të ndryshme për mbështetjen e inisiativave në komunitet për të zgjidhur probleme të ndryshme. Njohuritë për ngritje fondesh ndikuan tek pjesëmarrësit të mësojnë dhe të dinë alternativat për ngritje fondesh në komunitet por edhe për të qartësuar çështjen e organizimit të aktiviteteve me pak fonde kështu organizatat krijuan ide të reja ku mund të kërkojnë fonde përveç donacioneve duke mobilizuar burimet lokale. Rëndësi të veçantë në trajnim dhe që ndikonte në punën e organizatave lokale në komunitet ishte trajtimi i lidershipit. Diskutimet nxorrën në pah karakteristikat që duhet të ketë një lider i suksesshëm. Organizatat lokale kanë një rol të rëndësishëm për organizimin dhe motivimin e komunitetit për t'u mobilizuar. Diskutimi mbi lidershipin theksoi rëndësinë që ka mbështetja e liderit nga komuniteti dhe rëndësinë e mbështetjes dhe bshkëveprimit të liderave të komunitetit me njëri-tjetrin

Gjatë trajnimit organizatat lokale mësuuan koncepte të reja të cilat do t'u shërbejnë atyre për të punuar në komunitet dhe për të pasur efektivitet. Kështu pjesëmarrësit morën informacion për çështjet:

Si të hartojmë dhe përgatisim një projekt propozim (elementet që duhen për hartimin e një projekti, vendosja e qëllimeve objektive, përshkrimin e problemit, ndërtimin e buxhetit)

Si mund të ngrem fonde dhe ku mund të drejtohem për fonde (autoritet lokale, sponsorizimet, donacionet, bizneset, vetfinancimi, vendet e ndryshme ku organizatat mund të kërkojnë fonde për mbështetjen e problemeve të ndryshme në komunitet) Çfarë duhet të kemi parasysh kur kërkojmë mbështetje për fonde (Përshkrimin e saktë të problemit, planin e aktiviteteve dhe ndryshimin që ky aktivitet do të sjellë në komunitet). Organizatat lokale mësuuan rëndësinë e njohjes së misionit dhe natyrës së institucioneve apo organizatave ku do të kërkojnë fonde në mënyrë që të fitojnë mbështetjen. Një element i rëndësishëm që u theksua gjatë trajnimit dhe që organizatat lokale duhet të kishin parasysh, ishte mbështetja e aktiviteteve në komunitet që aktivizojnë komunitetin të ndërjegjësohet për kapacitetin që ka për të ndryshuar situatën në komunitet dhe jo të fiksohen në zgjidhjen e problemeve gjithmonë nga aktore të jashtëm. Organizatat lokale mësuuan mbi lidershipin: Karakteristikat e një lideri të suksesshëm; Llojet e liderave (autoritar, demokratik, karizmatik); Detyrat dhe përgjegjësitë e një lideri; Çfarë e dallon një lider të suksesshëm etj.

2 - Trajnimi i Liderave të rinj Rrom

Qëllimi: T'i mundësonte të rinjve rrom rritjen e njohurive në mënyrë që të përballen me efektivitet dhe kompetencë me çështjet e komuniteteve të tyre si

Lidera te ardhshëm.

Temat:

- Puna në Skuadër
- Zhvillimi i Komunitetit
- Prezantim i konceptit të Netëorkut
- Leadershipi
- Puna ne Komunitet

Përse ishte e nevojshme të fillohej diçka konkrete për të rinjtë rrom?

Situata aktuale e Komunitetit Rrom në Shqipëri është tepër e vështirë, treguesit e varfërisë, papunësisë, analfabetizmit dhe trafikimit janë të frikshëm.

Ky minoritet edhe pse është vendosur në mënyrë paqësore në vendin tonë që prej më shumë se 600 vjetësh, ende edhe sot e kësaj dite nuk po gjen një frymë normale bashkëjetese me bashkëkombasit, kjo si rrjedhojë e indiferencës për gjendjen e tyre, e paragjyqimeve dhe dallimit që i bëhet shpesh rromëve, ata ndjehen të diskriminuar dhe edhe pse ky diskriminim nuk është i hapur ai ka sjell vet-izolim e rromëve.

Të rinjtë rrom janë grupi më i marxhinalizuar në vendin tonë. Të rritur në kushte të vështira social-ekonomike dhe nën presionin dallues të shoqëris ata e kanë patur tepër të vështirë të depërtojnë në jetën sociale e kulturore të vendit. Shumica e tyre janë të papunë. Shumë rrallë gjen rrom të punësuar në Institucionet Shtetërore.

Qëllimi jonë është që të bëjmë diçka sot, ndryshe e nesërmja do të jetë përsëri e zyrtë. Tani është momenti i duhur për të vepruar dhe ndihmuar ata që nesër do të mbajnë peshën e një gjenerate të re.

Nesër do të jetë tepër vonë.

Proçesi i të mësuarit gjatë trainimit u realizua nëpërmjet të mësuarit ndërveprues dhe kombinimit të ushtrimeve praktike, informacionit teorik, rasteve studimore, shkëmbimit të eksperiencës, punës në grupe, diskutimeve, materialeve referuese, pyetësorëve, lojrave në situata reale etj.

Pjesmarrësit mësuan funksionin dhe rëndësinë e punës në ekip, Cështë komuniteti dhe parimet bazë të metodës Zhvillim Komuniteti, Cilësitë dhe stilet e një lideri të mirë, si të organizojmë komunitetin për zgjidhjen e problemeve.

Ata morrën njohuri fillestare për bashkëpunimin dhe Networkun.

Pjesmarrësit diskutuan dhe u ndërgjegjësuan për anët pozitive të diversitetit.

Atmosfera e hapur dhe lojrat e ndryshme krijuan një ambient të përshtatshëm për diskutime të lira dhe për të shkëmbyer eksperiencën të ndryshme.

Ky trainim u pasua nga një tjetër aktivitet për rininë rrome në Shqipëri, **Tryezë e Rrumbullakët për integrimin dhe përmirësimin e situatës së këtij grupi në vendin tonë**, financuar nga Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë, Soros.

Në tryezë morrën pjesë përfaqësues të 5 OJF-ve Rrome (Amaro Drom Tiranë, Shoqata Romano Drom Fush Krujë, Shoqata Alba Rom Durrës, Shoqata Gruaja rrome e së ardhmes Tiranë, Shoqata Romano Kham Tiranë); Perfaqësues Rinor të komuniteteve lokale rrome (Korcë, Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë e Kucovë); Përfaqësues të Këshillit të Europës në Shqipëri, Komiteti Shtetëror për Minoritetet, Komitetit Shqiptar i Helsinkit, Shoqata Gruaja në fokusin e zhvillimit, Shoqata në Mbrotjtje të të drejtave të fëmijëve si dhe përfaqësues të bordeve drejtuese të disa komuniteteve Lokale.

Nevojat dhe Prioritetet e Rinisë Rrome në Shqipëri

Në të gjitha sferat e jetës sociale, kulturore e politike shpallet se e ardhmja iu përket të rinjve. Por të rinjtë rrom kërkojnë një vëmendje të vecantë për përmirësimin e situates së tyre, në mënyrë që në të ardhmen të zenë vendin e duhur në shoqërinë shqiptare.

Disa nga nevojat dhe prioritetet e këtij grupi janë:

- Rritja e kapacitetit të përfaqësuesve (Liderave të ardhshëm) rinor rrom;
- Ngritja e nivelit arsimor dhe kulturor brenda komunitetit;
- Rritja e shkallës së frekuentimit të shkollave;
- Krijimi i vendeve vakante për të rinjtë rrom në shkollat profesionale dhe Univeristetet Shqiptare;
- Hartimi dhe zbatimi i trainimeve profesionale nga institucione të ndryshme;
- Përfshirja e rinisë rrome në Strategjinë Kombëtare të Rinisë;
- Krijimi i kushteve të caktuara për promovimin e aktiviteteve të organizatave rinore rrome;
- Gjetjen e alternativave të punësimit rinor, pjesmarrja në debate dhe diskutime;
- Gjallërimi i jetës sportive për këtë komunitet;
- Akses në mediat publike, ngritje kapaciteti dhe rritje të numrit të gazetarëve rrom;
- Veprimtari sensibilizuese për ndryshimin e mentalitetit të komunitetit;
- Të hartohen programe për shkëmbim eksperience dhe vizita që mund të fuqizojnë rininë rrome, të zhvillojnë besimin e tyre në forcat dhe kapacitetin e vet, të merret eksperiencë për të marrë pjesë aktivisht si qytetar, në aktivitete shkollore, sociale, shoqata etj.
- Të krijohet rrjeti kombëtar i të rinjve rrom;
- Të forcohet mundësia për pjesmarrje në aktivitete dhe netëork kombëtar dhe ndërkombëtar të të rinjve rrom;
- Të rriten mundësitë dhe mjetet e shpërndarjes së informacionit për mundësitë në angazhimin e të rinjve në jetën social-ekonomike të Shqipërisë.
- Një koordinimi efektiv i punës së strukturave kombëtare të rinisë apo për rininë për zbatimin e angazhimeve të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare “Për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rrom në Shqipëri” dhe Strategjinë Rinore;
- Fushata sensibilizuese për uljen e shkallës së diskriminimit dhe paragjykimeve brenda shoqërisë shqiptare;
- Publikime të ndryshme për rininë rrome;
- Rritja e bashkëpunimit midis OJF-ve Rrome dhe jorrome, institucioneve dhe organizmave të brendshëm dhe të jashtëm për përmirësimin e kësaj sate;
- Rritja e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar për promovimin e kushteve që favorizojnë zhvillimin e të rinjve nëpërmjet hartimit ose zhvillimit të politikave ekzistuese rinore si dhe vënien në funksion të këtyre arritjeve për të krijuar kushte që promovojnë pjesmarrjen e të rinjve në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Zhvillim i aktiviteteve dhe programeve për zhvillimin social, kulturor e ekonomik;
- Përfshirja e përfaqësuesve të OJF-ve Rrome në aktivitete të ndryshme me qëllim zbutjen e diferencave rinore;
- Hartim dhe zbatim i programeve (nga Pushteti Lokal) për trainimin dhe zhvillimin e të rinjve rrom në komunitetet lokale;
- Mbështetje të biznesit të vogël dhe ndërmarrjeve të vogla për të rinjtë rrom;
- Plotësim i legjislacionit për stimulimin e përfshirjes së të rinjve rrom në ndërmarrjet dhe kompanitë e biznesit privat;
- Stimulim i aktiviteteve vet-organizuese për rritjen e të ardhurave të këtij grupi;

- Programe për të drejtat, liritë dhe detyrimet;
- Programe për parandalimin e fenomenit të trafikimit të qënieve njerëzore;
- Programe për rritjen e vleresimit të rolit të gruas dhe problemet që ka ajo etj.

Rinia rrome si pjesë përberëse e rinisë shqiptare dhe e shoqërisë shqiptare në përgjithësi, kërkon një vemendje të vecantë për përmirësimin e kushteve në të cilat ndodhet. Një ndryshim i tillë mund të vij vetëm me përpjekje të përbashkëta të vet komunitetit rrom dhe e të të gjitha strukturave relevante Shqiptare.

3 – Vizitë për shkëmbim eksperience

Qëllimi i vizitës ishte shkëmbimi i eksperiencës dhe informacionit.

Gjatë vizitës, pjesmarrësit diskutuan dhe analizuan aspekte të ndryshme të punës së komunitetit të Kucovës, pikat e forta dhe të dobta u diskutuan në mënyrë që të nxirreshin mësimet dhe të shmangeshin gabimet në të ardhmen në komunitetet e tjera.

Cështja e parë e diskutuar ishte procesi i zhvillimit të komunitetit të Kucovës, për të cilin pjesmarrësit vlerësuan mënyrën e negociimit të bordit me autoritetet lokale dhe aktivitetet e ndryshme të cilat organizohen në kooperim nga organizatat e Kucovës (Kulture, aktivitete për fëmijët, gratë dhe të rinjtë). Shumë pjesmarrës (sidomos përfaqësuesit e bordeve të qytetit: Korca dhe Durrësi) mbetën të impresionuar nga keto arritje.

Cështja tjetër e diskutuar ishte “A kanë arritur projektet e realizuara të zhvillojnë sensin e pronësisë në komunitet? N.q.s PO, ku duket kjo? N.q.s JO, pse?”. Pas një analize të projekteve të ndryshme dhe mënyrës së realizimit të tyre, u arrit në konkluzionin se anëtarët e komunitetit rrom të Kucovës janë të ndërgjegjshëm se të mirat dhe ndryshimet në komunitetin e tyre nuk vijnë si dhuratë, por për t’i arritur ato duhet të angazhohet i gjithë komuniteti. Nga ana tjetër realizimi i një qendre të përbashkët komunitare dhe i kanalizimeve të ujrave të zeza, jo vetëm që është realizuar me punën e vet komunitetit, por gjithashtu ato i mbeten komunitetit dhe kjo duket në faktin se është vet komuniteti i cili kujdeset për mirëmbajtjen dhe funksionimin e tyre. Në fund të diskutimit të kësaj pike, pjesmarrësit ranë dakort se në të ardhmen në komunitetet e tyre do t’i kushtonin një rëndësi të vecantë sensibilizimit të komunitetit për vazhdueshmërinë dhe mirëmbajtjen e projekteve të kaluara.

Për cështjen e tretë “Pjesmarrja e bordit lokal dhe ndarja e detyrave midis tyre” pjesmarrësit shkëmbyen opinione të ndryshme dhe u arrit në përfundimin se në të gjithë bordet lokale ndarja e detyrave, marrja e vendimeve, pjesmarrja dhe marrja e përgjegjësisë bëhet në mënyrë të hapur dhe demokratike. „Bashkpunimet e organizatave lokale me aktorë të tjerë. Rëndësia e këtyre bashkpunimeve”, për të cilën pjesmarrësit diskutuan eksperiencat e ndryshme pozitive dhe negative me autoritetet lokale, institucionet shtetërore dhe organizatat e tjera joqeveritare. Mendime të shumta u hodhën për përmirësimin e procesit të negociimit me të tretët dhe për rritjen e besimit të liderave në aftësitë e tyre negociuese dhe përfaqësuese të interesave të komunitetit rrom.

Një cështje tjetër ishte „Ecuria e organizatave lokale pjesmarrëse. Sa e ndiejnë veten e tyre si zërin e komunitetit”, cështje për të cilën u hodhën ide të ndryshme përsa i përket përfaqësimit të komunitetit në nivel lokal dhe kombëtar. Inisiativat e ndryshme për bashkëpunim me organizata të ndryshme janë një tregues i qartë i rritjes së aftësive dhe përgjegjësisë së përfaqësimit të komunitetit të tyre. Përsa i përket aktiviteteve vet-organizuese dhe stimulimit të tyre, pjesmarrësit ranë dakort për rëndësinë e këtyre aktiviteteve në përmirësimin e kushteve ekonomike të komunitetit, në ndërgjegjësimin e tyre për organizimet e përbashkëta, në marrjen e përgjegjësisë dhe përmbushjen e tyre brenda afatit. Për këto aktivitete u ra dakort që të bëheshin studime të sigurta për tregun dhe planin e biznesit. Në përfundim, pjesmarrësit vlerësuan pozitivisht punën e Bordit dhe Komunitetit Rrom të Kucovës, i cili ka treguar se është një bord aktiv dhe i aftë për të organizuar komunitetin.

KAPITULLI 6

Përgatiti: Blerina Gjeka, Menaxhere Programi

Skema e Zhvillimit Lokal dhe Lidershit

Unioni Amaro Drom me mbështetjen e Fondacionit Internacional Spolu është duke zbatuar programin kombëtar "Zhvillim Komuniteti" në 9 komunitete Rrome të rretheve të ndryshme të Shqipërisë.


Ky Program synon:

- Ulje të varfërisë në nivel lokal;
- Përmirësim të pozicionit social të Romëve në nivel lokal dhe kombëtar;
- Lobim dhe advokasi në nivel lokal dhe kombëtar.

Amaro Drom po lufton për zhvillimin e komuniteteve Rrome, për forcimin dhe integrimin e tyre në mënyrë që anëtarët e këtij komuniteti të jenë pjestarë të respektuar të shoqërisë duke ruajtur identitetin e tyre dhe duke qenë të lirë për ta shprehur atë.



Përmirësimi i marrdhënieve midis Romëve dhe Autoriteteve Lokale, të përfaqësuesve të Institucioneve lokale dhe njerëzve të tjerë të maxhorancës është një aspekt tjetër i punës sonë.

Strategjia e aktiviteteve afatshkurtra të Amaro Drom Programi "Zhvillim Komuniteti" 2003 – 2005



Gjatë zbatimit të këtij programi ne kemi vëzhguar dhe studiuar ecurinë dhe zhvillimin e komuniteteve lokale. Fundi i vitit 2004 shënoi dhe përfundimin e fazës së dytë të programit për disa komunitete të cilat u përfshinë më parë në program dhe nisi kështu sfidën përfundimtare drejt krijimit të organizatave lokale të pavarura, zyrtare dhe partnere të Amaro Drom.


Në fillim Amaro Drom e filloi punën duke vepruar si një ndërmjetës midis komuniteteve lokale dhe Institucioneve të ndryshme (Modeli Arkitekturor), por shumë shpejt filozofia jonë ndryshoi dhe ne kërkuam që vet komuniteti të ishte aktori kryesor në procesin e zhvillimit (Modeli i trekëndëshit):




Kjo skemë ka sjellë fuqizimin në mënyrë të dukshme të komunitetit, krijimin e besimit të komunitetit në forcat e veta, krijimin e besimit për aftësitë dhe kapacitetin organizues e menaxhues të romëve tek autoritetet lokale.

PROCESI I ZHVILLIMIT TE KOMUNITETEVE RROME NEN ZBATIMIN E PROGRAMIT
”ZHVILLIM KOMUNITETI”.

1 - NDERGJEGJESIMI:



2 - AKTIVIZIMI:



3 - QENDRIMI DHE MENTALITETI:

Njerëzit kanë një vizion të qartë për të ardhmen, në fillim ata kërkonin ndihma ekonomike, pas kalimit të fazes së parë të programit vihet re se komuniteti kërkon më tepër mbështetje për ta përmirësuar vet situatën, për të pasur arritje afatgjata dhe janë më të hapur për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin.

4 - KAPACITETI DREJTUES (Leadership):

Bordi lokal është i aftë të drejtojë dhe organizojë komunitetin, të formulojë dhe të hedhi hapa për zgjidhjen e problemeve, të negociojë me Autoritetet Lokale dhe të marrë përgjegjësi për realizimin e aktiviteteteve. Liderat e grupeve të ndryshme (bordi, gratë dhe të rinjtë) janë të përgatitur për realizimin e detyrave, mobilizimin e grupeve brenda komunitetit dhe përfaqësimin e komunitetit të tyre në nivel lokal dhe kombëtar.

5 - PJESMARRJE:


Gjatë zbatimit të projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme është vënë re se anetarët e komunitetit marrin pjesë aktivisht nën ndikimin e këtyre faktorëve:

- Ndjenja e Komunitetit (kultura, bashkjetesa, ndarja e problemeve të njëjta);
- Investim burimesh (para, kohë dhe energji) nga anetarët e komunitetit;
- Natyra publike (qëllimi i përbashkët, mbledhje të hapura);
- Transparenca dhe Korrektesa;
- Ndërgjegjësim për kapacitetin dhe mundësitë për të bërë ndryshime;
- Vet-vlerësim, vet-inisiativa, vet-vendosje dhe vet-organizim;
- Marrëdhënie të mira bashkëpunimi me maxhorancën, grupet e tjera etnike dhe Autoritetet Lokale;
- Transparenca, krijimi i besimit dhe motivimi.

6- STRUKTURAT SOCIALE:

Brenda komunitetit janë krijuar struktura dhe nëngrupe lokale të qëndrueshme. Duke qenë të aktivizuar në projekte vet-organizuese nëngrupe të ndryshme (gratë, të rinjtë, grupet e iniciativave ekonomike etj) kanë realizuar me sukses aktivitete të cilat kërkonin vetorganizimin e grupit, bashkëpunimin e anëtarëve brenda grupit, ndarjen e përgjegjësisë, të qenit pjesë e procesit, marrjen përsipër të rrishtit, ndarjen e detyrave dhe kërkimin e zgjidhjeve të mundshme duke patur parasysh përfitimin e të gjithë grupit.

Të tilla aktivitete janë, psh: aktivitete sportive të grupeve të të rinjve, aktivitetet për rritjen e të ardhurave, aktivitete vetorganizuese të grave të realizuara brenda të njëjtit komunitet.




7- VENDIM-MARRJE DEMOKRATIKE:

Bordet drejtuese të komunitetit janë zgjedhur me votim nga vetë anëtarët e komunitetit. Për të pasur një vendim-marrje sa më demokratike bordet përbëhen nga 5, 7 ose 9 persona përfaqësues të grupeve të ndryshme: burra, gra dhe të rinj. Rëndësi e veçantë i është dhënë marrjes së vendimeve në mënyrë të hapur dhe transparente kundrejt komunitetit: bordi ka bërë takime të hapura me komunitetin për probleme të ndryshme, takime dhe diskutime me grupe të ndryshme, fise të veçanta dhe familje brenda komunitetit. Një element i rëndësishëm i këtij procesi është mundësia e një vendi/zyre/qendre ku komuniteti dhe bordi kanë mundësi të takohen dhe të diskutojnë probleme dhe çështje të

ndryshme. Të tilla zyra komunitare janë hapur në Levan, Moravë, Kucovë, Novosel e së fundi në Savër, Lushnje.

8 – VIZIBILITET DHE NDIKIM:

Aksionet e ndërmarra synojnë edhe vizibilitetin e komunitetit rrom në nivel lokal dhe kombëtar, duke patur parasysh që këto veprime të sjellin vërtet përmirësim të jetës, zbatim të të drejtave njerëzore tek përfituesit, të sjellin ndryshime jo vetëm brenda komunitetit por edhe në shoqëri, ndryshimi të jetë i qëndrueshëm dhe zgjidhjet të mos jenë momentale.




9 - PAVARESIA:

Një nga treguesit e fuqizimit të Bordeve dhe komuniteteve lokale është dhe dalja e tyre si struktura të pavarura, zyrtare dhe partnere të Amaro Drom.


Liderat Rrom kanë identifikuar këto avantazhe dhe disavantazhe të pavarësisë:

Avantazhet e Pavarësisë së Bordeve	Disavantazhet e Pavarësisë së Bordeve
Vet organizim / Vet vendosje	Kërkon kohë dhe energji nga puna
Ndërgjegjësim i komunitetit dhe Bordit	e përditshme, për t'i shërbyer komunitetit.
Zhvillim i liderave	
Fuqizim i bordit	Fillim i vështirë financiar
Vizibilitet i komunitetit	
Mobilizim për të zgjidhur problemet e veta	Ndjenjë e fortë përgjegjësie ndaj komunitetit
Bashkëpunim i fortë me Autoritet Lokale	
Vet inisiativa	Kërkon kohë, energji dhe dëshirë për të
Zëri i vetë komunitetit	punuar për komunitetin
Ndjenjë e fortë përgjegjësie ndaj komunitetit	
Zgjidhje të problemeve	
Forcim i lidhjeve brenda komunitetit	
Rritje e kapacitetit të bordit	

Skema e mëposhtme tregon situatën aktuale te Unionit Amaro Drom dhe vizionin e së ardhmes për të patur komunitete lokale të pavarur dhe partneritet të vazhdueshëm me to.




VIZIONI I SE ARDHMES




10 – ALEANCAT:

Një tjetër hap i rëndësishëm në procesin e zhvillimit të komunitetit është dhe krijimi i aleancave me institucione, organizata e element të tjerë të cilët ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e komunitetit. Komunitetet lokale dhe bordet që i udhëheqin ata kanë filluar tashmë të krijojnë lidhjet e tyre, me anë të bashkëpunimeve, kontakteve dhe punës konkrete me shumë institucione, organizata, autoritetet lokale etj.



11 – NETWORKU:



Gjatë seminareve dhe trainimeve të ndryshme lidrat rrom kanë identifikur këto avantazhe dhe disavantazhe të krijimit dhe hyrjes së tyre në Network.

AVANTAZHET E NETWORKUT	DISAVANTAZHET E NETWORKUT
Shkëmbim Eksperience/Shkëmbim Informacioni	Kërkon kohë, energji dhe dëshirë për të punuar për komunitetin
Bashkëpunim për projekte me interes reciprok	
Një Zë i Përbashkët për të gjithë Rromët	
Ekspertizë dhe Ndihmë për njeri tjetrin	Do t'ju duhet të harxhoni kohë nga puna juaj e përditshme, për t'i shërbyer komunitetit.
Mbështesin njeri tjetrin	
Zgjidhin probleme dhe mësojnë nga gabimet e njeri tjetrit	
Shmang gabimet e të tjerëve	
Zgjerohen mundësitë tuaja; Ju mund të fitoni bashkë çfarë nuk mund ta fitoni vetëm.	Nëse Rrjeti priset mund të dëmtohet imazhi i gjithë komunitetit.
Ofron siguri për mbrojtje për anëtarët që nuk mund të jenë në gjendje për të ndërmarrë vet veprime.	
Rrit mundësitë për burime financiare	Fillim i vështirë financiar
Rrit transparencën, Kredibilitetin dhe influencën e Organizatave Lokale	
Zgjeron Qëllimin e punës tuaj	Për një periudhë kohe mund të jetë pasiv
Të bën të fuqishëm	
Vizibilitet i fuqishëm i komunitetit Rrom në arenën Kombëtare dhe Nderkombëtare	
Zhvillim të lidërshiptit lokal	
Ndërhyrje të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve madhore të komunitetit në rang Lokal dhe Kombëtar.	
Ushtrim presioni dhe Fushata të përbashkëta të suksesshme	
Përgjegjësi me të mëdha	
Advokim për ndryshim të legjislacionit në favor të komunitetit Rrom	
Mobilizim i të gjithë komunitetit në momente/situata specifike	

Kjo ishte skema me anë të së cilës ne kemi punuar për arritjen e rezultateve konkrete në realizimin e objektivave dhe aspiratave tona. Ne jemi krenar dhe tepër të kënaqur që puna jonë ka mundur të rregulloj disi një situatë në dukje të pashpresë.

Ne kemi besim tek një komunitet që ka kaq shumë vlera dhe është i gatshëm të punoj me devotshmëri për të zënë pozicionin që i takon në shoqërinë shqiptare.

ZHVILLIM KOMUNITETI

Amaro Drom:

Skënder Veliu
Blerina Gjeka
Adriatik Hasantari
Sadete Arapi
Valbona Dervishi
Mimoza Pepmarku
Aida Ndreu
Alma Lleshi

Redaktore: Alma Lleshi

Financuar nga:
Fondacioni Internacional SPOLU